

## **SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS**

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar Ligjor (1 pozitë)
<b>Grada e pozitës:</b>	P06
<b>Kohëzgjatja e punësimit:</b>	Me afat të pacaktuar
<b>Departamenti:</b>	Ligjor
<b>Divizioni:</b>	Përfaqësim Ligjor
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqësi i Divizionit për Përfaqësim Ligjor

### **Përmbledhje e Detyrave dhe Përgjegjësisë:**

- Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të Bankës Qendrore para gjykatave dhe institucioneve tjera të drejtësisë;
- Bashkëpunon me departamentet/divizionet përkatëse gjatë procesit të përfaqësimit gjyqësor;
- Kryen veprime përgatitore me qëllim të përfaqësimit sa më profesional në konteste të ndryshme kur BQK-ja paraqitet si palë;
- Ushtron mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike, varësisht nga rasti në institucionet kompetente;
- Bashkëpunon me personat e autorizuar për përfaqësim të BQK-së;
- Mban evidencën përkatëse për rastet e përfaqësuar dhe njofton mbi dukuritë dhe ecuritë e rasteve të ndjeshme;
- Ofron konfirmime dhe opinione ligjore për aktet juridike (njoftimet për masa administrative dhe draft vendimet tjera);
- Ofron opinione ligjore, rekomandime dhe këshilla sipas kërkesës nga mbikëqyrësi;
- Ofron mbështetje ligjore për njësitë organizative të BQK-së lidhur me zbatimin e kornizës rregullative nga fushë veprimtaria e njësive përkatëse;
- Ofron mbështetje ligjore në hartimin e propozim-vendimeve nga fushëveprimi i njësive përkatëse;
- Kryen detyra të tjera në kuadër të përgjegjësisë të divizionit.

### **Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:**

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë;
- Njohje e ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës me theks të veçantë të legjislacionit që zbatohet ndaj institucioneve financiare, të punës, mbi procedurën administrative, kontestimore, përmbartimore, marrëdhëniet e detyrimeve, etj;

- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar e gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Preferohet të ketë certifikime nga fusha e përmendur më lartë;
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

#### **Përvoja profesionale e kërkuar:**

- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën e cila ndërlidhet me përgjegjësitë e njësisë organizative, sipas përshkrimit të publikuar në këtë shpallje si dhe uebfaqen e BQK-së në linkun: [Departamentet e Guvernatorit - BQK](#).

#### **Kërkesat e posaçme:**

- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe shkrim ligjor-(formulim të parashtresave, shkresave të ndryshme, rekomandimeve dhe opinionëve ligjore);
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi;
- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e çështjeve sipas prioriteteve;
- Vetiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore;

#### **Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së gjatë aplikimit online** nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të **bashkëngjisin letër përcjellëse (motivuese)**, e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur **posaçërisht për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës, që mbulojnë paku dy (2) vite përvojë pune** (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti) për periudhën përkatëse, që mbulon paku dy (2) vite përvojë pune**, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

#### **Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **29 maj 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.